



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 77 Datë 15.10.2007

PËR

NDRYSHIMIN E DISA ZËRAVE TË SHPENZIMEVE
OPERATIVE SI DHE RRYTJE LIMITI PËR KLUBIN
SHUMËSPORTËSH "SKËNDERBEU"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, «PËR NDRYSHIMIN E DISA ZËRAVE TË SHPENZIMEVE OPERATIVE SI DHE RRYTJE LIMITI PËR KLUBIN SHUMËSPORTËSH "SKËNDERBEU", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e zërave në shpenzimet operative të Klubit Shumësportësh "Skënderbeu", si më poshtë:

Zërat	Plani i vitit 2007 sipas buxhetit	Ndryshimi + -		Plani i rishikuar
		Shtesa	Pakesime	
Trajtim+Trajnerë+Gjyqtari	6 700 000	+ 20 000		6 720 000
Licensimet	180 000	+ 50 000		230 000
Shpenzime Telefonie	160 000	+ 90 000		250 000
Komision bankar	165 000		- 120 000	45 000
Dietë	4 500 000	+ 20 000		4 520 000
Mikpritje personalitetesh	30 000		- 30 000	---
BlerjeKarburant (gjenerator)	---	+ 40 000		40 000
TOTALI	11 735 000	+ 220 000	- 150 000	11 805 000

2. Të miratojë rritjen e limitit nga të ardhurat e dyta të institucionit në vlerën 70.000 lekë të cilat do të kalojnë për

- Licensime + 50 000 lekë, për arsye se federata e basketbollit ka rritur vlerën e federimit të sportistëve.
- Udhetim-Dietat + 20 000 lekë për ekipet, sipas kësaj strukture buxhetore:

Shtohet	00	08140	05	Art 6020000	M/Shtator 2007 + 70 000 lekë
---------	----	-------	----	-------------	---------------------------------

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashki dhe Klubi Shumësportësh "Skënderbeu".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE